

STATUT
I
URDHRIT TE FARMACISTËVE TE SHQIPËRISË

Kreu I

PARIME TË PERGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Statuti i Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë (me poshtë Statuti) ka për qëllim rregullimin normativ të të gjithë veprimtarisë së Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë (më poshtë Urdhri) dhe organeve të tij.

Neni 2
Baza Ligjore

Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë është krijuar në bazë të Ligjit Nr. 9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3
Përcaktimi

Ligji Nr. 9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë” e përcakton Urdhrin si Ent Publik, i cili përbëhet nga individë, që ushtrojnë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë dhe përfaqëson interesat e tyre profesionale në nivel partneriteti institucional.

Sipas Ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, me Ent Publik do të kuptohet çdo subjekt i të drejtës publike, jo shtetëror, i krijuar me ligj dhe që synon realizimin e një interesi publik.

Neni 4
Natyra

Urdhri i Farmacistëve është ent publik jobuxhetor, krejtësisht profesional i shoqërisë civile. Ai është i depolitizuar dhe i departizuar, i hapur dhe i barabartë për të gjithë anëtarët, pavarësisht nga përkatësitë e tyre racore, fetare apo bindjet politike.

Eshtë kategorikisht e ndaluar që gjatë veprimtarisë së tyre, në organet e strukturat e të gjitha niveleve të Urdhrit, të diskutohen apo reflektohen dukuri ose probleme të karakterit politik, partiak, racor, etnik e fetar.

Neni 5
Përbërja

Urdhri përbëhet nga farmacistë që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë dhe që përmbushin kriteret e përcaktuara nga Këshilli Kombëtar për të qënë anëtarë,

sipas Ligjit Nr. 9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrit e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”.

Anëtarë të Urdhrit bëhen individët, shtetas shqiptarë, të titulluar farmacistë në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, që pranojnë Kodin Deontologjik Farmaceutik Shqiptar dhe që ushtrojnë këtë profesion në sektorin e prodhimit farmaceutik, të shërbimit dhe të shpërndarjes farmaceutike, ambulatorie e spitalore, publike e private, ose në sektorë të tjerë të shëndetësisë.

Përfshihen nga ky detyrim, por jo nga e drejta e anëtarësimit në Urdhër, farmacistët funksionarë të administratës publike, për sa kohë që ata nuk ushtrojnë veprimtari të mirëfilltë profesionale farmaceutike.

Anëtarë Nderi të Urdhrit, mund të shpallen personalitete të shquara farmaceutike, vendase ose të huaja, për kontribute të rëndësishme të farmaceutikës.

Ndihmës Farmacistët e diplomuar në shkollat e mesme profesionale, të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministria e Shëndetësisë, që në momentin e funksionimit të Urdhrit ishin pajisur me leje nga Ministria e Shëndetësisë për të punuar në Agjenci Farmaceutike apo ishin regjistruar pranë QKKB-së dhe punonin në farmaci në prani të farmacistit, nuk mund të jenë anëtarë të këtij Urdhri. Ata regjistrohen në një regjistër të veçantë dhe gjatë ushtrimit të profesionit janë të detyruar t'i nënshtrohen detyrimeve ligjore, Statutit, Kodit Deontologjik Farmaceutik dhe akteve të tjera të cilave u nënshtrohen farmacistët.++++

Neni 6

Parakushte për ushtrimin e profesionit

Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit.

Punëdhënësit në institucionet apo ndërmarrjet shtetërore ose publike dhe në subjektet private, ndalohen t' i punësojnë ata në kundërshtim me këtë dispozitë.

Shtetasit e huaj, për ushtrimin e profesionit të farmacistit në sektorin farmaceutik të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të antarësohen në Urdhër, të njohin dhe të zbatojnë Kodin Deontologjik Farmaceutik Shqiptar, si dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë shërbimin farmaceutik dhe atë shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, të paraqesin dëshminë e provimit të kualifikimit në gjuhën shqipe nga institucionet përkatëse të licensuara dhe të njohura nga Ministria e Arsimit si dhe ti nënshtrohet një testimi me gojë nga Komisioni i ngritur pranë Urdhrit të Farmacistëve. Këshilli Kombëtar i Urdhrit përcakton kriteret për pranimin e farmacistëve në Urdhër.

Neni 7

Misioni dhe funksionet kryesore të Urdhrit

Urdhri ka për mision ruajtjen dhe garantimin e nivelit të lartë të formimit dhe edukimit shkencor e profesional të farmacistëve, ushtrimin e profesionit sipas kërkesave shkencore të përditësuar, normave të etikës farmaceutike e të Kodit Deontologjik Farmaceutik Shqiptar, legjislacionit farmaceutik në fuqi dhe mbrojtjen e pacientëve e të konsumatorëve nga kequshtrimet profesionale dhe shkeljet e normave të detyrueshme.

Në përmbushje të këtij misioni, Urdhri:

- kryen regjistrimin e farmacistëve në një regjistër të veçantë, sipas modelit të përcaktuar nga Këshilli Kombëtar;

- mbikëqyr zbatimin e detyrave profesionale në përputhje me Kodin Deontologjik Farmaceutik, kërkesat shkencore farmaceutike dhe të legjislacionit farmaceutik;
- bashkëpunon me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, Fakultetet e Mjekësisë, si dhe institucione të tjera arsimore e shkencore për hartimin dhe planifikimin e programeve të formimit shkencor, të specializimit pasuniversitar, të kualifikimit të vazhdueshëm të farmacistëve si dhe të provimit të shtetit ;
- mbikëqyr zbatimin e kërkesave të Kodit Deontologjik Farmaceutik, në mbrojtje të interesave të pacientëve dhe të konsumatorëve;
- jep dhe heq të drejtën vetjake për ushtrimin e profesionit, sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli Kombëtar.
- mbikëqyr respektimin e të drejtave dhe detyrave të personave që ushtojnë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë, sipas rregullave të Kodit Deontologjik Farmaceutik Shqiptar, për mbrojtjen e popullatës nga kequshtrimi i profesionit dhe cënimet e etikës farmaceutike, si dhe veprimet e tjera, që privojnë kujdesin e nevojshëm farmaceutik.
- mbron farmacistët nga veprimet arbitrare të administratës publike ose private për ushtrimin e profesionit, sipas legjislacionit në fuqi.
- garanton që anëtarët e Urdhrit përmbushin detyrimet e programit të ricertifikimit të vendosur nga institucioni përkatës.

Neni 8 Marrëdhëniet e Urdhrit

Urdhri si institucion, gjatë kryerjes së detyrave mban lidhje të vazhdueshme, nëpërmjet përfaqësimit ndërinstitucional, me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, me institucionet e saj vartëse si dhe me ministrinë e tjera, me institucionet qendrore dhe organizma të tjerë publikë ose jopublikë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi.

Urdhri i Farmacistëve informon çdo 6 muaj ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë lidhur me antarësimet, gjykimet disiplinore dhe problemet e tjera me interes të ndërsjellë. Ky informacion publikoet në faqen e internetit të Urdhrit.

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë bashkëpunon me Urdhrit e Farmacistëve për hartimin e projekt ligjeve dhe të dokumenteve të rëndësishme në fushën e farmaceutikës.

Kreu II

Pjesa e parë ANËTARËSIMI DHE RIANËTARËSIMI

Neni 9 Anëtarësimi

Anëtarësimi në Urdhër kërkon nga individi, që do të anëtarësohet:

1. Të jetë i diplomuar në një Universitet në Shqipëri në degën Farmaci me cikël unik pesëvjeçar të akredituar, nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Shqipërisë, për këtë degë studimi përpara lëshimit të diplomës në fjalë, ose në një Universitet të huaj, diploma e të cilit duhet të njihet nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi.
2. Për të diplomuarit në degën Farmaci, pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.10171 datë 22.10.2009 “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, aplikohen dispozitat e këtij ligji dhe modifikimet perkatëse.
3. Në momentin e kërkesës për anëtarësim, të mos jetë në ndjekje penale ose vuajtje të dënimit për çështje të papajtueshme me normat etiko-morale të profesionit dhe të Kodit Deontologjik Farmaceutik. Në rast se kandidati është në ndjekje penale, anëtarësimi i tij shqyrtohet vetëm pas vendimit përfundimtar të formës së prerë, dhënë nga organet e drejtësisë.
4. Të paraqitet personalisht, të njohë dhe të zotohet me shkrim që do të zbatojë kërkesat e Kodit Deontologjik Farmaceutik si dhe legjislacionit farmaceutik në fuqi
5. Të paguajë rregullisht kuotizacionin e anëtarësisë.
6. Farmacistët e huaj, që ushtrojnë profesionin në Shqipëri, duhet të jenë anëtarë të organizmit homolog me Urdhrin në vendin e tyre dhe të njohin gjuhën shqipe.

Neni 10

Çertifikata e Anëtarësimit dhe Çertifikata e Regjistrimit

- 1.Çertifikata e Anëtarësimit është dokumenti zyrtar i lëshuar nga Urdhri, që vërteton anëtarësimin për të drejtën e ushtrimit të profesionit, në funksionin e përcaktuar të një veprimtarie farmaceutike.
- 2.Çertifikata e Anëtarësimit është individuale dhe jepet sipas kriterëve dhe dokumentave të përcaktuara nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit.
3. Çertifikata e Anëtarësimit jepet për një afat 5 vjeçar, me përjashtim të periudhës 2011-2014 e cila do të jetë 4 vjeçare në përputhje të plotë me programet e edukimit në vazhdim.
- 4.Çertifikata e Anëtarësimit, për drejtues teknik dhe të punësuar, i jepet çdo farmacisti të regjistruar në Urdhër.
- 5.Çertifikata e Regjistrimit, për drejtues teknik dhe të punësuar, i jepet çdo ndihmës farmacisti të regjistruar në Regjistrin e Posaçëm të Urdhrit.
- 6.Modelet e Çertifikatave miratohen me vendim të Këshillit Kombëtar.

Neni 11

Karta e Anëtarësimit

Karta e Anëtarësimit është mjet identifikimi, për farmacistin dhe ndihmësfarmacistin, ndaj pacientit dhe është e detyrueshme të mbahet në bluzën e bardhë gjatë kohës së punës.

Neni 12

Dokumentat e kërkuara

1. Dokumentacioni i nevojshëm për anëtarësimin/rianëtarësimin e farmacistëve dhe ndihmësfarmacistëve në Urdhër miratohet me vendim të Këshillit Kombëtar.

2. Këshilli Kombëtar miraton :

- a) Formularin 1, i cili përmban dokumentacionin e nevojshëm për anëtarësim .
- b) Formularin 2, i cili përmban dokumentacionin e nevojshëm në rastet e ndryshimeve.
- c) Kërkesën individuale për anëtarësim.
- d) Vetëdeklarimin e farmacistit dhe ndihmës/farmacistit.
- e) Dokumenta shtesë të miratuara me vendim të Këshillit Kombëtar për raste të veçanta .

Neni 13

Mënyra e anëtarësimit

1. Dokumentacioni i kërkuar për anëtarësim dhe ndryshimet në vazhdim plotësohet nga vetë personi dhe dorëzohet pranë Këshillit Rajonal përkatës.
2. Kryesia e Këshillit Rajonal shqyrton dhe verifikon dokumentacionin e kandidatit në të dy rastet e lartpërmendura dhe, kur gjykon se çdo gjë është konform rregullave në fuqi, ia percjell zyrës qendrore të Urdhrit.
3. Dokumentacioni original dërgohet pranë Zyrës Qendrore të Urdhrit, nga Presidenti i Këshillit Rajonal.
4. Zyra Qendrore pranon dokumentacionin dhe ia percjell për shqyrtim dhe miratim “ Komisionit të Rregjistrimit dhe Dhënies së të Drejtës së Ushtrimit të Profesionit” i ngritur me Urdhër të Presidentit të UFSH-së. “Komisioni i Rregjistrimit dhe Dhënies së të Drejtës së Ushtrimit të Profesionit” mblidhet jo më pak se 4 herë në muaj.
5. Farmacisti tërheq personalisht pranë Zyrës qendrore të UFSH Çertifikatën e Anëtarësimit dhe Kartën e Anëtarësimit.

Neni 14

Pagesa për anëtarësim

Për veprimet e kryera për anëtarësim e regjistrim, kërkuesi paguan tarifën, e cila përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar të Urdhrit.

Neni 15

Ankimi për refuzimin e anëtarësimit

Ndaj vendimit, që refuzon kërkesën për anëtarësim e regjistrim, kërkuesi ka të drejtë të ankohet pranë Këshillit Kombëtar jo më vonë se 30 ditë nga dita e shpalljes dhe marrjes së njoftimit për vendimin. Këshilli Kombëtar e shqyrton atë jo më vonë se 2 muaj nga paraqitja e ankesës. Ky vendim është i formës së prerë.

Kërkuesi ka të drejtë t'i drejtohet Këshillit Rajonal përsëri me kërkesë vetëm 6 muaj pas përgjigjes negative të Këshillit Kombëtar, vetëm nëse ka plotësuar kriteret e duhura për anëtarësim.

Neni 16 **Farmacistët në pension**

Farmacistët në pension që nuk ushtrojnë profesionin, njihen si anëtarë të Urdhrit pa qënë të detyruar të paguajnë Kuotizacionin e Anëtarësisë. Kur ata punësohen ose vetpunësohen detyrohen të paguajnë edhe kuotizacionin e Urdhrit. Farmacistët që nuk ushtrojnë profesionin, sepse vuajnë nga një sëmundje invalidizuese, që nuk pajtohet me kushtet që kërkon ushtrimi i profesionit dhe/ose e bën ushtrimin e profesionit të rrezikshëm për popullatën, mbeten anëtarë të Urdhrit si pensionistët.

Neni 17 **Riçertifikimi**

Riçertifikimi bëhet kur është mbushur afati 5 vjeçar dhe anëtari ka plotësuar kreditet e përcaktuara të edukimit të vazhdueshëm profesional deri në momentin e riçertifikimit si dhe çdo detyrim tjetër të legjislacionit në fuqi dhe akteve e normativave të Këshillit Kombëtar.

Riçertifikimi bëhet sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli Kombëtar dhe pas plotësimit të Formularit të Riçertifikimit, pranë Këshillit Rajonal përkatës.

Neni 18 **Ndërprerja e anëtarësimit**

Anëtarësimi në Urdhër pushon së qëni në këto raste:

1. Me vdekjen e anëtarit.
2. Kur anëtarit i hiqet e drejta e ushtrimit të profesionit me vendim disiplinor të formës së prerë nga organet e Urdhrit apo Gjykatës.
3. Kur anëtarët janë duke vuajtur dënimin penal me heqje të lirisë për krime, që bien ndesh me profesionin.
4. Vërtetohet se farmacisti ka përdorur dokumente të fallcifikuara për të marrë lejen e ushtrimit të profesionit të farmacistit.
5. Vuan nga një sëmundje e rëndë (mendore e te tjera, e vërtetuar me raport mjeko ligjor) ose dëmtime të rënda fizike, të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin normal të profesionit.

Vendimi për ç'regjistrim i komunikohet zyrtarisht personit, institucionit ku ka shërbyer dhe në raste të veçanta, u bëhet i ditur të gjithë farmacistëve dhe institucioneve të tjera shëndetësore.

Anëtarësimi nuk pushon kur anëtari kryen kurse kualifikimi apo specializimi brenda dhe jashtë shtetit, me miratim paraprak të Presidentit të Urdhrit.

Neni 19 **Leja e ushtrimit të profesionit**

Leja e Ushtrimit të Profesionit është individuale dhe jepet sipas kritereve të përcaktuara me vendim nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit.

Me Leje Ushtrimi Profesionit pajiset çdo farmacist anëtar aktiv **vetëm në Urdhrin e Farmacistëve** dhe çdo ndihmës farmacist i regjistruar në Regjistrin e Veçantë të ndihmës farmacistëve.

Leja e Ushtrimit të Profesionit bëhet e pavlefshme kur farmacistit apo ndihmës farmacistit i është ndërprerë anëtarësimi apo regjistrimi.

Për të marrë Lejen e Ushtrimit të Profesionit çdo farmacist duhet të paraqesë pranë Zyrës Qendrore të Urdhrit, Çertifikatën e Anëtarësimit dhe një fotografi, kurse çdo ndihmës farmacist Çertifikatën e Regjistrimit dhe një fotografi.

Modelet e Lejeve përcaktohen dhe miratohen me vendim nga Këshilli Kombëtar.

Cdo anëtar i Urdhrit të Farmacistëve mund të aplikojë për të qenë drejtues teknik nëse plotëson parakushtet e vendosura në Ligjin “Për barnat dhe Shërbimin Farmaceutik” si dhe plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) Të jetë anëtar aktiv vetëm i Urdhrit të Farmacistëve
- b) Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore sipas parashikimeve të nenit 18 pika d) dhe e) të ligjit 9150 “Për Urdhrin e Farmacistëve” brenda një periudhe 3 vjecare.
- c) Të mos vuajë nga probleme shëndetësore që e bëjnë të pa mundur ushtrimin e profesionit.
- d) Të plotësojë dispozitat e Kodit të Punës për sa i përket prezencës së tij në subjektin farmaceutik.
- e) Nuk është duke ushtruar një detyrë tjetër publike e cila përbën konflikt interesi sipas ligjit “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”
- f) Në rastet e dypunësimit, për drejtuesin teknik, dypunësimi do të lejohet vetëm brenda qytetit.

Drejtuesit teknik i pezullohet leja për ushtrimin e profesionit si drejtues teknik në mënyrë të menjëhershme:

- a) Kur në farmaci gjendet duke shërbyer një person jo farmacist.
- b) Kur deklaratat e bëra tek Formulari i Deklarimit të Ndryshimeve janë të rreme.
- c) Kur në farmaci gjendet, në mënyrë të përsëritur, duke shërbyer një farmacist pa qenë anëtar i Urdhrit të Farmacistëve.

Pezullimi në mënyrë të menjëhershme i lejës për ushtrimin e profesionit për rastet e parashikuara në pikat a) dhe b) bëhet për një periudhë 3 vjecare, kurse për rastin e parashikuar në pikën c) pezullimi i lejës për ushtrimin e profesionit bëhet për një periudhë 1 vit. Ankimi ndaj këtyre masave bëhet brenda 30 ditëve drejtpërsëdrejti në gjykatë.

Në rastin kur subjekti farmaceutik ushtron aktivitetin pa patur të punësuar një drejtues teknik, farmacistit të punësuar në këtë farmaci i pezullohet licenca deri në momentin e pajisjes së farmacistit me drejtues teknik.

Në rastin kur pronar i subjektit farmaceutik nuk është farmacist, pronari i farmacistit duhet të nënshkruajë një deklaratë pranë Urdhrit të Farmacistëve, ku të deklarojë se ai personalisht nuk do të ndikojë në ushtrimin e veprimtarisë profesionale të drejtuesit teknik apo farmacistit në farmacistinë që ai ka në pronësi.

Pjesa e dytë

TË DREJTAT DHE DETYRAT E ANËTARËVE

Neni 20 Të drejtat

Anëtari i Urdhrit të Farmacistëve ka të drejtë:

1. Të ushtrojë profesionin në specialitetin e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi, me normat e Etikës dhe Kodit Deontologjik Farmaceutik.
2. Të kërkojë mbrojtje, nga Urdhri, për shkeljen e të drejtave të tij profesionale dhe të Kodit Deontologjik, nga cilido qoftë.
3. Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e Urdhrit.
4. Të marrë pjesë në shqyrtimin nga organizmat e Urdhrit për probleme që kanë të bëjnë me të.
5. Të apelojë vendime të Urdhrit kur i gjykon se janë të padrejta.

Neni 21 Detyrat

Anëtari i Urdhrit të Farmacisteve ka detyrë:

1. Të respektojë normat, ligjet dhe rregullat në fuqi në lidhje me ushtrimin e profesionit, sipas kërkesave të shkencave farmaceutike e mjekësore, normave të Etikës dhe të Kodit Deontologjik Farmaceutik.
2. Të punojë pa ndërprerje për rritjen e standardeve të tij profesionale dhe në përputhje me të gjitha normat, të kërkojë të zbatohen arritjet bashkëkohore në ushtrimin e profesionit të farmacistit prej tij dhe kolegëve të vet.
3. Të shlyejë në kohë kuotizacionin e anëtarit dhe çdo detyrim tjetër financiar ndaj Urdhrit.
4. Të zbatojë të gjitha vendimet e marra nga Këshilli Kombëtar. Në raste shkeljesh të këtyre vendimeve, është i detyruar t'u nënshtrohet masave disiplinore sipas Rregullores së Gjykimit Disiplinor Profesional.
5. Të ketë në vendin e tij të punës literaturën themelore farmaceutike, botimet e Urdhrit, akte ligjore e nënligjore si dhe normativave që rregullojnë profesionin.
6. Të paraqesë pranë Urdhrit fotokopje të ID ose pasaportës si dhe të deklarojë pranë zyrave qendrore të Urdhrit të gjitha ndryshimet, që lidhen me ushtrimin e profesionit si: Emri, Mbiemri, Nr.tel, e-mail, emrin dhe adresën e subjektit ku ushtron profesionin si dhe kopje të genplanit dhe planvendosjen e tij.

Kreu III

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

Pjesa e parë Organet e Urdhrit

Neni 22 Organet

1. Organet kryesore të Urdhrit janë:

- a) Asambletë e Urdhrit.
- b) Këshillat e Urdhrit.
- c) Komisionet Disiplinore të Gjykimit Profesional.
- d) Presidentët e Urdhrit
- e) Komisione apo grupe pune të përhershme ose të përkohshme, të ngritura me vendim të Këshillit Kombëtar në përputhje me nevojat në vazhdimësi të Urdhrit.

2. Zgjedhjet në organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni duhet të sigurojnë përfaqësim në masën 30 për qind për cdo gjini, në përputhje me ligjin Nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

Neni 22/1 Presidentët e Urdhrit

1. Presidentët e Urdhrit zgjidhen me votim të fshehtë nga Këshilli Kombëtar dhe ai rajonal midis jo më pak se 2 kandidaturave alternative.

2. Këshilli Kombëtar zgjedh Presidentin e Urdhrit të Farmacistëve me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Mandati i presidentit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm njëherë.

3. Këshillat rajonalë zgjedhin presidentët përkatës të këshillave rajonalë. Mandati i tyre është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

4. Kandidaturat për presidentë të Urdhrit të Farmacistëve duhet të përmbushin këto kritere:

- a) të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;
- b) të kenë jo më pak se 15 vjet eksperiencë në profesion;
- c) të kenë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikimi, organizimi e drejtimi;
- d) të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

5. Funkzioni i presidentëve të Urdhrit të Farmacistëve është i papajtueshëm me cdo funksion tjetër administrativ, shtetëror apo politik.

Neni 23 Asambletë dhe Këshillat

Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga tërësia e anëtarëve të Këshillave Rajonale. Asambleja e Përgjithshme zgjedh Këshillin Kombëtar. Zgjedhjet për anëtarë të Këshillit Kombëtar bëhen çdo 5 vjet, me të drejtën e një rizgjedhjeje.

Këshilli Kombëtar zgjedh Presidentin dhe Zëvendësin e tij me një mandat 5 vjecar, me të drejtën e një rizgjedhjeje.

Asambleja e Përgjithshme cakton Komisionin e Gjykimit Disiplinor Profesional të Këshillit Kombëtar .

Mbledhja e Asamblesë thirret nga Presidenti si dhe, kur kërkohet, nga 2/3 e anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

Asambleja Rajonale përbëhet nga tërësia e anëtarëve të Urdhrit të Rajonit(qarkut). Asambleja Rajonale zgjedh Këshillin Rajonal. Zgjedhjet në Këshillin Rajonal bëhen çdo 5 vjet, me të drejtën e një rizgjedhjeje. Këshilli zgjedh Presidentin dhe Zëvendësin e tij. Asambleja thirret nga Presidenti i Këshillit Rajonal dhe, në raste të jashtëzakonshme, me kërkesën e 2/3 të anëtarëve të Këshillit Rajonal. Në këto raste, mbledhja bëhet pasi merret paraprakisht miratimi i Presidentit të Këshillit Kombëtar. Asambleja Rajonale mund të thirret direkt nga Presidenti i Urdhrit.

Neni 24

Këshilli Kombëtar dhe drejtimi i tij

Këshilli Kombëtar përbëhet nga:

1. Anëtarë të zgjedhur nga Asambleja, Presidenti i Urdhrit, Zëvendësi i tij dhe Presidentët e Këshillave Rajonale.
2. Një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë, një përfaqësues i Institutit të Sigurimeve Shëndetësore dhe një përfaqësues i Departamentit të Farmacisë së Fakultetit të Mjekësisë.
3. Anëtarë të kooptuar nga vetë Këshilli Kombëtar, që përfaqësojnë aktorë të tjerë të sistemit farmaceutik me të drejtë vote këshillimore.

Për mbarëvajtjen e Urdhrit në përmbushje të misionit dhe funksioneve të tij, në Këshill mund të zgjidhet edhe përfaqësues nga publiku, me të drejtë vote këshillimore.

Rastet e largimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar parashikohen në nenin 32 të këtij Statuti.

Ky Këshill emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm.

Këshilli Kombëtar mbledhet jo më pak se 4 herë në vit. Këshilli thirret nga Presidenti, në mungesë të tij nga Zëvendëspresidenti, si dhe me kërkesën e 1/3 së anëtarëve me të drejtë vote vendimore.

Për të organizuar dhe drejtuar veprimtarinë e Këshillit Kombëtar dhe të gjitha strukturave të tjera të Urdhrit, pranë Këshillit Kombëtar funksionon Aparati Qendror Ekzekutiv dhe Bordi Drejtues i tij.

Këshilli Kombëtar merr vendime, me shumicë votash, kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve me të drejtë vote vendimore.

Neni 25

Detyrat e Këshillit Kombëtar

Këshilli Kombëtar udhëheq të gjithë veprimtarinë e Urdhrit. Për përmbushjen e misionit të tij, përveç detyrave të specifikuara në nene të veçanta të këtij Statuti, Këshilli Kombëtar:

1. Harton dhe miraton Kodin Deontologjik Farmaceutik dhe organizon mbikëqyrjen dhe zbatimin e tij.

2. Harton dhe miraton Statutin, strategjitë e zhvillimit të Urdhrit, rregulloret e funksionimit të këshillave dhe organizmave vartëse;
3. Përcakton dhe miraton strukturën organizative të Këshillit Kombëtar dhe Këshillave Rajonale.
4. Përcakton kriteret e anëtarësimit në Urdhër, dokumentacionin e anëtarësimit, modelet e çertifikatave, lejes së ushtrimit të profesionit dhe çdo dokument tjetër të lëshuar nga Urdhrit.
5. Cakton kuotizacionin, tarifën e regjistrimit dhe çdo lloj tarife tjetër, që lidhet me funksionimin e këtij organi.
6. Miraton buxhetin dhe administrimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme të Urdhrit në nivel kombëtar dhe rajonal.
7. Mbikëqyr të gjitha veprimtaritë dhe administrimin e organeve që varen prej tij.
8. Miraton veprimtarinë kombëtare kryesore për njohjen dhe ndërgjegjësimin e të gjithë farmacistëve me aktet normative, misionin, synimet, funksionet dhe detyrat e Urdhrit.
9. Mbikëqyr dhe ndërhyr në rregullimin e marrëdhënieve të punës së farmacistëve dhe të subjekteve të tyre private me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.
10. Njëpërmjet sensibilizimit të gjithë anëtarëve të tij sensibilizon dhe informon opinionin publik për misionin dhe funksionet e Urdhrit si dhe deklaron pozicionet e tij për probleme dhe situata të veçanta farmaceutike me interes publik.

Me anë të strukturave të veta të zgjedhura apo të emëruara të Aparatit Qendror Ekzekutiv:

11. Miraton pagat, kuotizacionet, kuotat e honorareve, tarifat e regjistrimit, të liçensimit dhe rilicënsimit, si dhe tarifa të tjera që lidhen me funksionimin e tij.
12. Organizon dhe mbikëqyr procesin e regjistrimit dhe mban të përditësuar Regjistrin e Farmacistëve në nivel kombëtar.
13. Organizon dhe mbikëqyr veprimtaritë për rilicënsimin periodik të farmacistëve.
14. Koordinon bashkëpunimin dhe bashkëveprimin e nevojshëm me organizmat përkatëse për ruajtjen e standardeve të larta në përgatitjen e farmacistëve, në përzgjedhjen dhe specializimin e tyre, në ushtrimin e profesionit si dhe për kualifikimin e vazhdueshëm profesional të tyre.
15. Organizon grupe pune me karakter kombëtar dhe kontrollon periodikisht veprimtarinë e tyre.
16. Me strukturat e veta organizon sipas përkatësive dhe specifikave të veçanta bashkëpunimin me organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare të vendit dhe të huaja.
17. Organizon kualifikimin e veçantë për anëtarët dhe pjesëtarët e strukturave të Urdhrit si dhe botimet e nevojshme.
18. Bën propozime për projekt-ligje dhe projekt-vendime që i konsideron të domosdoshme për përmirësimin e standardeve.
19. Bën propozime për dekorime dhe vendos për vlerësime të ndryshme etj.
20. Mban marrëdhënie me organizma analoge të huaja dhe ratifikon marrëveshje dhe protokolle bashkëpunimi.

Neni 26
Bordi Drejtues i Aparatit Qendror Ekzekutiv

Bordi Drejtues përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm, Shefi i Sektorit Ekonomik – Financiar, Farmacisti dhe Juristi.

Ai është organ ekzekutiv, i cili organizon, kontrollon e mbikëqyr zbatimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit Kombëtar dhe të urdhëresave dhe udhëzimeve të Presidentit të Urdhrit. Me anë të komisioneve, grupeve të veçanta të punës dhe konsulencave të specializuara të aparatit, ai mbikëqyr e kujdeset për zbatimin me përpikmëri të Ligjit, Statutit e Rregulloreve në të gjitha strukturat e Urdhrit.

Bordi Drejtues:

1. Organizon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e Aparatit Qendror të Urdhrit.
2. Harton dhe i paraqet për miratim Këshillit Kombëtar:
 - Objektiva dhe strategji për zhvillimin e Urdhrit si dhe projekt-vendime dhe çështje të tjera për shqyrtim.
 - Bën bilancin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të Urdhrit.
 - Harton projekt-buxhetin e vitit financiar pasardhës, të ndarë sipas zërave dhe për çdo rajon.
 - Harton projekt-rregullore për veprimtarinë e strukturave dhe organeve të Urdhrit.
3. Përcakton deklarinimin e pozicioneve të Urdhrit për probleme të veçanta me interes publik.
4. Mbikëqyr, kontrollon, analizon dhe ndihmon veprimtaritë e Këshillave Rajonale dhe strukturave të tjera të Urdhrit.

Neni 27

Presidenti i Urdhrit të Farmacistëve

Presidenti i Urdhrit zgjidhet dhe shkarkohet me votim të fshehtë nga Këshilli Kombëtar. Për zgjedhjen e Presidentit paraqiten për votim 2 ose më shumë kandidatura, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 9/1 të Ligjit Nr. 128/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9150, datë 30.10.2003, Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”.

Presidenti i Urdhrit ka këto detyra e kompetenca:

1. Udhëheq dhe mbikëqyr të gjitha veprimtaritë e Urdhrit.
2. Nxjerr vendimet e miratuara nga Këshilli Kombëtar dhe Asambleja e Përgjithshme.
3. Nxjerr urdhëresa e udhëzime për mbarëvajtjen e punës.
4. Miraton propozimet e Bordit Drejtues.
5. Thërret mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit Kombëtar dhe të Bordit Drejtues.
6. Kërkon, sipas rastit, mbledhjet e Asambleve apo Këshillave Rajonale.
7. Përfaqëson Këshillin Kombëtar dhe Urdhrin në marrëdhënie me organe dhe organizma qeveritare dhe joqeveritare brenda dhe jashtë vendit. Në pamundësi, ia delegon këto kompetenca Zëvendësit të tij ose Sekretarit të Përgjithshëm.
8. Ndërmerr nisma propozimi në organe ligjvënëse e vendim- marrëse për projekt-ligje dhe dokumenta të rëndësishme për farmaceutikën shqiptare, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse.

9. Propozon në stukturat e Urdhrit sipas përkatësisë dhe rëndësisë së problemit, kandidatura për t'u zgjedhur, kooptuar ose shkarkuar në organet e Urdhrit si dhe për dekorime, vlerësime, shpërblime, ndihma etj.
10. I delegon të drejtën e nënshkrimit për Urdhrin, Zëvendësit të tij dhe, në raste të veçanta Sekretarit të Përgjithshëm.
11. Vetë dhe me propozim të Bordit drejtues, emëron dhe shkarkon punonjësit e Aparatit, që nuk janë të zgjedhur.

Neni 28

Sekretari i Përgjithshëm

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjësi kryesor për problemet tekniko-organizative të Këshillit Kombëtar dhe të Aparatit të tij. Ai duhet të jetë farmacist.

Sekretari i Përgjithshëm përmbush këto detyra:

1. Kujdeset për krijimin, organizimin e drejtimin e komisioneve e grupeve të punës dhe kontrollon veprimtarinë e tyre ose, sipas rastit, edhe i kyeson ato. Në mënyrë të veçantë kujdeset për hartimin e projektit të Kodit Deontologjik Farmaceutik, si dhe të të gjitha rregulloreve të tjera për veprimtaritë e organeve të Këshillave të Urdhrit dhe Aparatit Qëndror.
2. Mban kontakte me Këshillat Rajonale dhe koordinon veprimtarinë e tyre.
3. Përgatit dokumentacionin për mbledhjet e Këshillit Kombëtar, të Bordit Drejtues dhe të komisioneve e grupeve të punës.
4. Mban kontakte me organizmat qevitare dhe joqevitare të vendit dhe të huaja.
5. Raporton dhe informon sistematikisht Presidentin e Urdhrit dhe Këshillin Kombëtar.

Neni 29

Këshillat Rajonale

Këshilli Rajonal krijohet në bazë qarku.

Këshilli Rajonal përbëhet nga:

1. 5-9 anëtarë të zgjedhur nga Asambleja Rajonale me votim të fshehtë, mbi kandidatura alternative të ndara sipas përfaqësimit administrativo territorial rajonal, përfaqësimit gjinor, sektorëve farmaceutikë ku ushtrojnë profesionin, sipas kritereve të parashikuara në nenin 31. Këshilli Rajonal i Tiranës përbëhet nga 19 anëtarë.
2. Drejtuesi i Drejtorisë së Shëndetit Publik të rajonit dhe një farmacist nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor e rajonit përkatës, të cilët kanë të drejtë vote këshillimore.
3. Anëtarë të kooptuar nga vetë Këshilli, për zëvendësim lëvizjesh të mundshme të Këshillit Rajonal.

Për mbarëvajtjen e Urdhrit në përmbushjen e misionit dhe funksioneve të tij, në Këshill mund të zgjidhen përfaqësues nga publiku, me të drejtë vote këshillimore.

Këshilli Rajonal zgjedh Presidentin dhe Zëvendësin e tij. Këshilli Rajonal emëron dhe shkarkon Sekretarin e tij, i cili mund të jetë farmacist, jurist ose ekonomist.

Për të përmbushur funksionet dhe detyrat e tij Këshilli Rajonal:

1. Krijon dhe mban të përditësuar Regjistrin e Farmacistëve si dhe pasqyron anëtarësimin dhe riçertifikimin e farmacistëve në juridiksionin e vet.
2. Siguron zbatimin e vendimeve dhe udhëzimeve të Këshillit Kombëtar dhe të detyrave të ngarkuara nga Presidenti.
3. Kryen veprimtari për njohjen dhe ndërgjegjësimin e farmacistëve të rajonit të vet me aktet normative, misionin, synimet, funksionet dhe detyrat e Urdhrit.
4. Analizon periodikisht veprimtaritë e Urdhrit dhe organizmave të tij në rajon.
5. Zgjedh Komisionin Disiplinor në bazë të kriterëve të posaçme, si dhe komisione dhe grupe të tjera pune.
6. Sensibilizon dhe informon publikun e rajonit përkatës, për funksionin dhe kompetencat e Urdhrit, nëpërmjet veprimtarive të drejtpërdrejta me publikun ose nëpërmjet mediave lokale.
7. Përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta legjitime të profesionit të farmacistëve dhe deklaron publikisht opinionet e tij për ngjarje e situata të veçanta farmaceutike e mjekësore në rajon.
8. Organizon punën në rajon për mbledhjen e kuotizacioneve dhe të detyrimeve të tjera të anëtarëve.
9. Organizon bashkëpunimin me organizmat qeveritare dhe joqeveritare brenda rajonit, vendit dhe jashtë tyre.
10. I propozon Këshillit Kombëtar ose Presidentit të Urdhrit probleme e nisma që i quan të domosdoshme për të rritur standardet e shërbimit në rajonin e vet ose më gjerë.
11. Merr pjesë në organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive studimore shkencore dhe kualifikuese të farmacistëve të rajonit ose më gjerë.
12. I propozon Këshillit ose Presidentit të Urdhrit dekorime, vlerësime, shpërblime si dhe për ndihma në raste fatkeqësish për anëtarët e Urdhrit në juridiksion.
13. Të drejtën e nënshkrimit për çdo vendim të marrë nga Këshilli Rajonal si dhe Asambleja Rajonale e ka Presidenti i Këshillit Rajonal.

Neni 30

Thirrja e Këshillave Rajonale

Këshilli Rajonal thirret në mbledhjen e tij nga Presidenti ose, në mungesë të tij, nga Z/v. Presidenti.

Mbledhjet e Këshillit duhet të bëhen jo më pak se 4 herë në vit. Kur gjykohet e nevojshme, thirret mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit, por vetëm me miratim nga Presidenti i Urdhrit.

Neni 31

Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillave Rajonale

Kandidaturat për anëtarë të Këshillave Rajonale zgjidhen ndër farmacistët më të dalluar për përkushtim, aftësi dhe autoritet profesional. Përzgjedhja bëhet duke u orientuar nga këto kriterë kryesore:

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë mbushur moshën 28 vjeç.
3. Të jetë mbi 5 vjet i anëtarësuar në Urdhër.
4. Të ketë reputacion etiko-moral dhe prestigj profesional.
5. Të ketë shfaqur korrektësi në zbatimin e normave, ligjeve dhe rregullave të jetës shoqërore si dhe në komunikim me publikun, pacientët, kolegët dhe drejtuesit.

6. Mundësisht të jetë aktivizuar në veprimtari studimore dhe kualifikuese, publikuese farmaceutike dhe shëndetësore.
 7. Mundësisht të ketë grada e tituj shkencorë ose veprimtari pedagogjike.
 8. Të mos ketë kryer vepra penale si dhe, gjatë 3 vjetëve të fundit, të mos jetë ndëshkuar për shkelje të ushtrimit të profesionit.
 9. Të mos jetë i zgjedhur apo i emëruar në detyra funksionale drejtuese shtetërore.
- Mënyrat e përzgjedhjes përcaktohen edhe në Rregulloren e Zgjedhjeve të Urdhrit.

Neni 32 **Largimi i parakohshëm nga Këshilli**

Anëtari i Këshillit Kombëtar dhe atij Rajonal largohet para kohe nga Këshilli kur:

1. Kërkon vetë dorëheqjen.
2. Dënohet me vendim të formës së prerë për vepra penale, për shkelje në ushtrimin e profesionit ose shkelje administrativo-disiplinore.
3. Shpërdoron detyrën.
4. Mungon 3 herë radhazi në mbledhje të Këshillit pa shkaqe të arsyetuara.
5. Paaftësohet për arsye shëndetësore.
6. Paraqet paaftësi në kryerjen e detyrave.
7. Emërohet apo zgjidhet në detyra drejtuese shtetërore apo partiake, që bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 31 të këtij Statuti.

Neni 33 **Propozimi dhe vendimmarrja për largimin e parakohshëm**

Përveç pikës 1 të nenit 32, për të gjitha pikat e tjera, propozimin kanë të drejtë ta paraqesin :

- a) Për anëtarët e Këshillave Rajonale:
 1. Së paku $\frac{1}{4}$ e Asamblesë Rajonale.
 2. $\frac{1}{3}$ e anëtarëve të këtij Këshilli.
 3. Presidenti i Këshillit përkatës.
- b) Për Presidentët e Këshillave Rajonale:
 1. Së paku $\frac{1}{3}$ e Asamblesë Rajonale.
 2. $\frac{1}{3}$ e anëtarëve të Këshillit përkatës.
 3. Presidenti i Urdhrit.
- c) Për anëtarët e Këshillit Kombëtar:
 1. Së paku $\frac{1}{3}$ e Asmblesë së Përgjithshme.
 2. $\frac{1}{3}$ e anëtarëve të Këshillit Kombëtar.
 3. Presidenti i Urdhrit.
- d) Për Presidentin e Urdhrit:
 1. Së paku $\frac{1}{3}$ e Asamblesë së Përgjithshme.
 2. $\frac{2}{3}$ e anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

Në të gjitha rastet, përveç pikës 7 të nenit 32, vendimi merret me së paku $\frac{2}{3}$ e votave vendimore të anëtarëve të pranishëm. Në të gjitha rastet votimi bëhet i fshehtë, me përjashtim të rasteve kur vetë Këshilli përkatës vendos të kundërtën. Për rastet, që i përkasin pikës 7 të nenit 32, largimi është i detyrueshëm dhe nuk votohet.

Neni 34 **Njoftimi për mbledhjet**

Presidenti i Urdhrit apo Presidenti Rajonal vendos për datën, kohën dhe rendin e ditës së çdo mbledhjeje. Mbledhja e Këshillit Kombëtar apo Rajonal njoftohet me shkrim 7 deri më 14 ditë përpara, duke bërë të ditur edhe rendin e ditës.

Kriteret e mësipërme mund të mos zbatohen vetëm në raste e rrethana të veçanta. Në çdo mbledhje të tillë, duhet të jenë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve me të drejtë vote vendimore, të cilët paraprakisht miratojnë zhvillimin e mbledhjes.

Neni 35

Marrja e vendimeve

Këshilli Kombëtar apo Rajonal merr vendim vetëm për çështje, të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve ku të paktën 2/3 e anëtarëve me votë vendimore janë dakord për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve edhe për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

Neni 36

Vlefshmëria e mbledhjes

Mbledhja e Këshillit Kombëtar apo Rajonal është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij me të drejtë vote vendimore. Kur në hapjen e mbledhjes kjo shumicë nuk arrihet, Presidenti apo Zëvendësi, që drejton mbledhjen, vendos thirrjen e mbledhjes një ditë tjetër, duke përsëritur njoftimin me shkrim. Mbledhja është e vlefshme vetëm në qoftë se janë të pranishëm gjysma e anëtarëve me të drejtë vote vendimore.

Neni 37

Proces verbali i mbledhjes

Në çdo mbledhje mbahet një proces verbal ku shkruhet data, vendi i mbledhjes, pjesëmarrësit, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morrën si dhe forma e rezultati i votimit.

Presidenti i Këshillit Rajonal cakton një person për mbajtjen e proces verbalit, ndërsa, për Këshillin Kombëtar, Presidenti cakton një sekretari me dy persona.

Në mbarim të mbledhjes, proces verbali nënshkruhet nga mbajtësi dhe Presidenti ose drejtuesi i mbledhjes.

Neni 38

Forma e votimit

Vendimet merren me votime të hapura, përveç rasteve kur për arsye e rrethana të veçanta vendoset ndryshe. Vendimet që përmbajnë vlerësime mbi sjelljen ose cilësitë e një individi merren vetëm me votim të fshehtë.

Neni 39

Vlefshmëria e votës për të marrë vendime

Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votës vendimore, përveç rasteve kur kërkohet një shumicë e

cilësuar. Kur kjo e fundit nuk arrihet, atëhere kryhet një votim i dytë. Nëse edhe në votimin e dytë persëritet e njëjta situatë, atëhere vendimi shtyhet për t'u marrë në një mbledhje tjetër, në të cilën është e mjaftueshme një shumicë e thjeshtë votash. Në rastet kur votat barazohen dhe votimi nuk ka qënë i fshehtë, vota e Presidentit është vendimtare.

Pjesa II **KOMISIONET E URDHHRIT**

Neni 40 **Komisionet Disiplinore**

Pranë Këshillit Kombëtar dhe Këshillave Rajonale të Urdhrit funksionojnë Komisionet Disiplinore të Gjykimit Profesional të cilat caktohen nga Asambletë përkatëse.

Komisionet Disiplinore të Gjykimit Profesional janë organizma të pavarura të gjykimit profesional.

Ato verifikojnë dhe shqyrtojnë, çdo ankesë të depozituar pranë Urdhrit, për shkelje nga anëtarët e tij, të legjislacionit farmaceutik, Etikës Farmaceutike, të Kodit Deontologjik, Statutit dhe akteve të tjera normative të Urdhrit si dhe për kequshtrim profesioni dhe gabime profesionale. Komisionet Disiplinore të Gjykimit Profesional pranë Këshillave Rajonale ushtrojnë kompetenca disiplinore të shkallës së parë. Vendimet e tyre mund të apelojnë në Komisionin Disiplinor të Këshillit Kombëtar, i cili ushtron kompetenca disiplinore të shkallës së dytë dhe përfundimtare.

Këto Komisione Disiplinore të Gjykimit Profesional funksionojnë në bazë të Rregullores për Gjykimin Disiplinor Profesional, të miratuar nga Këshilli Kombëtar.

Neni 41 **Anëtarët e Komisionit Disiplinor të Gjykimit Profesional (KDGJP)**

Në përbërje të Komisioneve Disiplinore të Gjykimit Profesional për shkallën e parë të gjykimit (KD 1), i ngritur pranë KR zgjidhen 5 vetë përveç KDGJP pranë KR/Tiranë, që ka në përbërjen e tij 7 (shtatë) anëtarë, ndërsa në Komisionin Disiplinor të Gjykimit Profesional të shkallës së dytë (KD 2) i ngritur pranë Këshillit Kombëtar të Urdhrit ka në përbërjen e tij 15 anëtarë farmacistë.

Për të siguruar zhvillimin e një gjykimi profesional e të pavarur, të drejtë, e të ndershëm, të paanshëm dhe me kompetencë, përzgjedhja e anëtarëve të komisioneve disiplinore bëhet vetëm mbi bazën e kërkesave të larta cilësore dhe kriterëve individuale të specifikuar, të cilat janë të përshkruara më hollësisht në Rregulloren për Gjykimin Disiplinor Profesional.

Neni 42 **Kompetencat Ndëshkimore**

Komisioni Disiplinor i Gjykimit Profesional heton dhe gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara në seancë dëgjimore. Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje ai jep këto masa:

- a. Vërejtje me shkrim;
- b. Vërejtje me para lajmërim;
- c. Gjobë nga 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) deri në 100.000 (njëqind mijë) lekë .

- ç. Shkarkim nga organet drejtuese të Urdhrit dhe heqje të së drejtës për t'u rizgjedhur në këto organe.
 - d. Përfshirje nga anëtarësia në Urdhër deri në tre vjet, e cila nënkupton heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit për këtë periudhë.
- Gjobat e vjela sipas shkronjës “c” të këtij neni derdhen njëqind për qind në Buxhetin e Shtetit.

Neni 43

Detyrimi për kualifikim profesional

Përveç masave ndëshkuese për ruajtjen e standardeve të larta në ushtrimin e profesionit, Komisionet Disiplinore vendosin edhe detyrime me afate të përcaktuara, sipas veçorive të çdo rasti, për kualifikimin e nevojshëm profesional dhe të studimeve plotësuese me provimet përkatëse. Këto detyrime për zbatim, bashkërendohen, mbikëqyren dhe testohen nga Komisionet e Urdhrit së bashku me Departamentin e Farmacisë të Fakultetit të Mjekësisë.

Neni 44

Shpenzimet për proceset disiplinore

Të gjitha shpenzimet për çdo proces disiplinor përballohen nga Urdhri.

Neni 45

Ankimi për vendimet disiplinore

Ankimi kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore ndëshkimore, paraqitet në Komisionin Disiplinor të Këshillit Kombëtar të Urdhrit, brenda 30 ditëve nga komunikimi me shkrim i vendimit.

Komisioni Disiplinor i Këshillit Kombëtar, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankesës, detyrohet të japë vendimin për ankesën e paraqitur. Vendimi i Komisionit Disiplinor të Këshillit Kombëtar është i formës së prerë.

Për masat disiplinore “c” dhe “d” të nenit 42 të këtij Statuti, personi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës.

Neni 46

Komisione të tjera dhe grupe pune (ad-hoc)

Pranë Këshillit Kombëtar dhe Këshillave Rajonale, për të përmbushur funksionet e detyrat, që parashikon neni 2 i Ligjit 9150 datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”, në vartësi të detyrave dhe problemeve që duhen zgjidhur, në dinamikë dhe sipas rastit, krijohen komisione apo grupe pune të përhershme apo të përkohshme për:

1. Regjistrimin e anëtarëve dhe përditësimin e Regjistrit të Urdhrit;
2. Liçensim dhe riliçensim.
3. Standartet, arsimimin dhe kualifikimin.
4. Marrëdhëniet publike dhe marrëdhëniet me jashtë.
5. Planifikimin dhe kontrollin ekonomik-financiar.
6. Nxjerrjen e organit periodik dhe botime të tjera.
7. Komisione të tjera, që shikohen të domosdoshme.

Veprimtaria e këtyre komisioneve bazohet në rregulloret përkatëse, te cilat, për komisionet apo grupet e punës me karakter të përhershëm, miratohen nga Këshilli Kombëtar.

Pjesa III FINANCAT

Neni 47 Buxheti

Urdhri ka buxhetin e tij, të cilin e administron vetë në përputhje me rregullat financiare në fuqi. Burimet financiare të Urdhrit janë:

1. Kuotizacionet e anëtarëve.
2. Tarifat e regjistrimit dhe të dhënies së të drejtës vetjake për ushtrimin e profesionit.
3. Donacionet e ndryshme vendase dhe të huaja dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

Të ardhurat që realizohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Urdhri i përdor për të përmbushur misionin e tij të caktuar në Ligjin Nr.9150 datë 30.10.2003 “ Për Urdhrit e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 48 Kuotizacionet

Kuotizacioni mujor për anëtarët përcaktohet nga Këshilli Kombëtar në vartësi të gjendjes, kërkesave dhe nevojave për të siguruar funksionimin normal të Urdhrit. Shlyerja e kuotizacionit është e detyrueshme dhe kushtëzon anëtarësinë në Urdhër. Detyrimi për pagesën e kuotizacionit është detyrim mujorë dhe duhet të paguhet brenda vitit kalendarik.

Afati i fundit i pageses së kuotizacionit është muaji Mars i vitit pasardhës. Mospagimi i detyrimit të kuotizacionit përbën shkelje , me pasojë pezullimin e menjëhershëm të lejes së ushtrimit të profesionit deri në pagimin e plotë të detyrimit.

Neni 49 Përdorimi i burimeve financiare

Burimet financiare të Urdhrit përdoren për:

- a) Paga, honorare, ndihma në raste fatkeqësish për anëtarët dhe familjet e tyre, shpërblime pune dhe kontributin për sigurimet shoqërore e shëndetësore të punonjësve.
- b) Shpenzimet operative (kancelari, transport, ndërlidhje, energji, ujë, dieta, dokumentime fotografike, audio dhe videokaseta etj).
- c) Shpenzimet për organizim veprimtarish shkencore-profesionale e kualifikuese (konferenca, simpoziume, sesione, seminare për edukimin në vazhdim) etj.
- d) Shpenzimet për botime me karakter shkencor dhe informativ për nevoja të anëtarëve të Urdhrit.
- e) Investim e blerje mjetesh, pajisjesh pune për nevojat e veprimtarisë së Urdhrit.

- f) Shpenzimet për pritje e përcjellje delegacionesh e specialistësh nga organizma të ndryshme ndërkombëtare dhe vende të huaja.
- g) Shpenzimet për ceremoni të ndryshme përkujtimore për figura të shquara të farmaceutikës sonë dhe të huaj.
- Gj) Raste të veçanta, që përcakton Këshilli Kombëtar.

Neni 50
Shpërblimet Financiare

Mbledhjet dhe veprimtaritë e ndryshme të Këshillave të Urdhrit, të Komisioneve si dhe aktivizimi i ekspertëve për konsulenca, hartim projektesh dhe materialesh të rëndësishme, për grupe pune dhe shërbime të tjera në funksion të Urdhrit shpërblimet bëhen sipas tarifave të miratuara nga Këshilli Kombëtar.

Kreu IV

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 51
Emërtimi

Emri i organizmit është **URDHRI I FARMACISTËVE TË SHQIPËRISË.**

Neni 52
Stema dhe vula

Urdhri ka stemën dhe vulën e tij (Këshilli Kombëtar dhe Këshillat Rajonale)

Neni 53
Rezidenca

Rezidenca e Urdhrit është në Tiranë.

Neni 54
Llogaria Bankare

Urdhri mban llogari bankare në lek dhe valutë të huaj.

Neni 55
Organi Periodik

Urdhri nxjerr organin e tij periodik, Revistën "Farmaceutika.

Miratuar me VKK Nr.6.Prot, Date 18/05/2006, rishikuar me VKK Nr.22, date 09.07.2010, VKK Nr.9, date 09.09.2013, VKK Nr.6, date 24.01.2014.